



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 08.10.2019)

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:39 dhe mbaroi në orën 14:46.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Illir Toska* (anëtar)
8. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
9. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
10. *Marçela Shehu* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje zoti *Alban Toro*, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Antuen Skënderi, Këshilltare e Kabinetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
6. *Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
7. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*

RENDI I DITËS:

1. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e datës 8 tetor.

Të pranishëm janë të gjithë, përveç zotit Toro.

Për shkak se kuorumi është, KLGJ-ja do vazhdojë mbledhjen.

Shkaku i mbledhjes së sotshme është caktimi i një gjyqtari në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, për gjykimin e një çështjeje tepër urgjente.

Për hedhjen e shortit, fjalën ia kaloj kryetarit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, zotit Toska.

Ilir Toska: Atëherë, kemi përgatitur një relacion për caktim gjyqtari në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda. Nevoja e gjykatës në këtë rast konsiston në faktin se sot më datë 8 tetor 2019, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, ka mbërritur për trajtim një kërkesë nga kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda për caktim gjyqtari për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, me karakter tepër urgjent. Në fakt, më herët, ishte nisur edhe një kërkesë tjetër, bëhet fjalë për të njëjtën çështje, por urgjenca në këtë rast konsiston në faktin se gjatë gjykimit të çështjes penale, i pandehuri në atë rast ka paraqitur edhe një kërkesë për shuarjen e masës së sigurimit.

Referuar nenit 45 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve” konkludohet se zbatimi i mekanizmit të skemës së delegimit është i pamundur për shkak të padisponueshmërisë së gjyqtarëve në skemë delegimi, ndërkohë që është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, referuar nenit 46 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve”, nisur kjo nga fakti se nevoja e gjykatës në këtë rast është vetëm për një çështje, çka do të thotë që transferimi i jo më pak se dy gjyqtarëve, siç kërkohet, do të krijojë një efekt negativ më të madh në gjykatën nga gjyqtarët do duhet të transferohen. Prandaj bëhet i zbatueshëm mekanizmi i caktimit të gjyqtarëve për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar vendimit përkatës të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Vlen të theksohet se, referuar informacionit të parashtruar në kërkesën e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda për caktim gjyqtari të datës 07 tetor 2019, nevoja e identifikuar në këtë rast konsiston në një çështje penale që ka të bëjë me një kërkesë të pandehurit për shuarjen e masës së sigurimit “arrest në burg”, paraqitur gjatë gjykimit të themelit të çështjes penale kundër tij, kërkesa këto që, sipas vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 7, të vitit 2011, shqyrtohen nga trupi gjykues që gjykon themelin e çështjes penale. Pra, praktikisht, pavarësisht paraqitjes së dy kërkesa formale për caktim gjyqtari nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, nevoja në këtë rast e kësaj gjykate konsiston vetëm në një çështje penale, asaj për gjykimin në themel të çështjes, identifikuar në tabelë si çështja nr. 1, nevojë për të cilën është paraqitur kërkesë për caktim gjyqtari më datë 25.09.2019 (protokolluar në Këshill me nr. 4700 prot., datë 26.10.2019). Nisur nga kjo, është vendi që Këshilli të trajtojë kërkesën e datës 25 shtator 2019, trajtimi i të cilës i jep zgjidhje dhe kërkesës tepër urgjente të datës 07.10.2019, identifikuar në tabelë si çështja nr. 2. Në këtë rast, ngutshmëria për trajtimin nga Këshilli të kërkesës së datës 25 shtator 2019 rezulton nga fakti se i pandehuri ka paraqitur kërkesë për shuarjen e masës së sigurimit “arrest në burg”.

Në konsideratë të kriterëve të përcaktuara në paragrafin IV, pika 5, të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, si dhe në zbatim të paragrafit VI, pika 4, të këtij vendimi, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, propozon që gjykata nga duhet të

përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 2.

Në opsionin e pranimit të propozimit si me lart, për hapat e shortit që duhet të ndiqen, Komisioni propozon që për 1 çështje penale, atë nr.1, për të cilën kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen, me short, ndërmjet gjyqtarëve të Seksionit Penal të Çështjeve Penale të Themelit, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në këtë rast, Komisioni propozon edhe përjashtimet nga shorti referuar paragrafit VIII të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, konkretisht në shortimin e kësaj çështjeje të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që është me leje lindjeje, konkretisht: znj. {...}. Po kështu, të përjashtohet nga shorti edhe kryetari në detyrë, zëvendëskryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, zoti {...}.

Këto ishin propozimet e Komisionit.

Nëse jeni dakord me propozimet, mund të procedojmë më tej.

(Zonja Ukperaj flet pa ndezur mikrofonin.)

Përveçse kanë të gjithë mbi 5 vjet këto që janë këtu, por nuk është më kusht.

A jeni dakord me propozimet e Komisionit?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Mirë, meqenëse Këshilli është dakord, vazhdojmë me procedurën e shortit.

Në një enë duhet të hidhni emrat e gjyqtarëve të Seksionit Penal të Çështjeve Penale të Themelit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që janë: {...}...{...}.

Po, mund t'i hidhni të gjithë në një enë. Mund t'i lexoni duke i hedhur në enë.

Valbona Bako: {...}...{...}.

(Përzgjidhet i pari {...}.)

{...}.

(Përzgjidhet i dyti {...}.)

{...}.

Ilir Toska: Atëherë, dy emrat e përzgjedhur nga shorti janë {...} dhe {...}. Me kaq mbyllen procedurat e shortit. Faleminderit!

Naureda Llagami: Me kaq mbyllim edhe mbledhjen e ditës së sotshme. Faleminderit!

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor